



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
 Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

<b>DATË/A:</b>	06.03.2025
<b>REFERENC-Ë:</b>	24/5651/MMPHI
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"Vinex" Sh.p.k. Fabrikë për prodhimin e produkteve metalike, Rr. e Preshevës, Viti.
<b>CC:</b>	Komisioni për Leje Mjedisore
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Arkivës së MMPHI-së
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka kontrolluar dokumentacionin për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Vinex" Sh.p.k. me veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e produkteve metalike, Rr. e Preshevës, Viti. me Nr.Prot.24/5651/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*


*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 24/5651/MMPHI  
Datë: 06.03.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 2 të nenit 12 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Operatori "Vinex" Sh.p.k. pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e produkteve metalike, Rr. e Preshevës, Viti. me Nr.Prot.24/5651/MMPHI, në ngastrën nr. 02484-77, zona kadastrale Viti.
2. Operatori obligohet:
  - 2.1 Të bënë mbikëqyrjen në vazhdim të sistemimit të mbeturinave metalike në platetë e sipërfaqes operuese dhe të sistemohen pjesët e çmontuara në hapësirat e mbyllura;
  - 2.2. T'i përmbahet kushteve të Lejes Ujore për shkarkim;
  - 2.3. Në mënyrë të rregullt të mirëmbahen basenet për seperimin dhe sedimentimit e vajrave, të bëhet zbrazja e tyre në vazhdimësi nga kompania e kontraktuar;
  - 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit të mjedisit;



- 2.5. Të kontrollohen në vazhdim kolektorët për grumbullimin e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e grumbullimit të mbetjeve të metalit;
- 2.6. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

## A r s y e t i m

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, te dt.30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Çertifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 11/250/1-ZSP-53/11, data lëshimit:16.03.2011;
- Leje Ujore për shfrytëzim, Nr.5652/24-ZSP-2024, datë: 26.12.2024;
- Leje Ujore për shkarkim, Nr.5653/24-ZSP-2024, datë: 26.12.2024;
- Kontratën për shitblerjen e zinkut të fortë dhe hirit (shkumës) së zinkut, e lidhur me datë: 09.07.2021;


Komisioni pas pranimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si më poshtë:

- Lejen Ujore për shfrytëzim;
- Lejen ujore për shkarkim dhe
- Kontrate nga Kompania e Licensuar për largimin e mbetjeve.

Operatori ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të cekur me lartë, andaj bazuar dhe në faktet e grumbulluara nga terreni për plotësimin e kushteve administrative dhe mjedisore, MMPHI, konstatoi se operatori i plotëson kriteret e parapara për tu pajisur me Leje Mjedisore, të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 3 të UA/MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës/MMPHI, vlerëson se operatori i plotëson kushtet administrative/ dhe mjedisore merr Vendim për pajisje me **Leje Mjedisore**.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Viti;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.